Mëse e qartë. Udhëheqja politike e minoriteti grek vetpërshtat qëndrimin e vet në përputhje të plotë me dëshirat e faktorit shqiptar. Ato përbejnë pikën e referimit dhe orientimit. Kjo ndodh për faktin se tanimë është Tirana dhe jo Athina që u garanton atyre para dhe pushtet. Janë votat fiktive të elektoratit shqiptar që e çon PBDNJ-në në parlament dhe në qeveri të majta apo të djathta, pavarësisht se kjo bëhet në emer të Greqisë dhe mbrojtjes së të drejtave të minoritetit grek. Kujt do t'i mbushi mendjen faktori nacionalist shqiptar që flet për vigjilencë nga "nacionalizmi" i përfaqësuesve politikë të minoritetit grek, kur këta i ka të lidhur me pesëqind zinxhira? PBDNJ-shi hyri në qeverinë e PD-së pas nënshkrimit të një marrëveshjeje. Dy pikat e saj ishin, regjistrimi popullsisë dhe shkollat në gjuhën amtare. Asnjëra nuk po realizohet. Bile po përgatiten kushtet për kartën e identitetit. Në të serish nuk do të shenohet kombësia. PBDNJ-shi dhe OMONIA heshtin edhe pse në mbrojtjen e tyre për Bollanon thonë se në deklaratën e tij kishte parasysh minoritete etnike në shtete të tjera që gëzojnë të drejta etnike të aspiruara nga minoriteti etnik grek (!!). Po ashtu kritikën e PBDNJ-së ndaj qeverisë Berisha nuk lidhen me këto të drejta por janë mjete presioni që kryeministri të shtojë poste qeveritare për qejfmbeturit e kryetarit të kësaj partie.....

P. Barka, për gazetën ABC 01.05.2007

Nga Panajot Barka

## **Çfarë fshihet pas propozimit të Berishës për një numër të caktuar mandatesh për deputetë nga minoritetet (minoriteti grek)?!!**

21.05.2007

Kohët e fundit po rievidentohen përpjekjet për të mbajtur në të njëjta pozita inferioriteti parametrat vlerësues të integritetit moral e etnik të minoritetit etnik grek në Shqipëri. Madje, ato kthehen në sistem gjykues dhe vlerësues të këtij integriteti nga ky minoritet, si individë dhe komunitet. Psh, në një reportazh gazete për minoritetin “Orestis” nga Derviciani i Dropullit, thoshte që “ne nuk dim se çfarë jemi, përderisa në Greqi na thonë se jemi shqiptarë dhe në Shqipëri se jemi grekë”. Pra, ky zotëria dhe shumë të tjerë, përballë presionit të përmendur, ka “humbur” të drejtën e vetpërcaktimit të identitetit të vet dhe pret t’ja përcaktojë atë të tjerët.

Po ashtu, në emisione televizive dhe gazeta shohim se fundmi një këmbëngulje për të imponuar pretendime të tilla si: Himariotet nuk duhet t’i lejojmë të quajnë vetën minoritet grek. Së shumti ata duhet ta quajnë vetën greqishtfolës. Ose minoritarët grekë s’duhet ta quajnë vetën Vorioepirotë, se kjo ngjall “predikimet teritoriale të Greqisë ndaj Shqipërisë” (!!!). Aq më keq s’duhet ta quajnë vetëm Vorioepirot shqiptarët në këtë pjesë të Epirit, ose Veriut të tij, se mund të konfondohen në grekë.

Me të njëjtën brutalitet i mohohet këtij minoriteti e drejta për të përkujtuar data, ngjarje, përsosha, apo dokumente historike, që përbëjnë shtyllën vërtetore të kontinuitetit etnik të historisë së tij të re dhe të lashtë. Apo i mohohet dhe vet kjo histori dhe i imponohet një histori e fabrikuar, që i fyen ata deri në të drejtën për t’u ankuar në gjykatën ndërkombëtare për shkeljen e të drejtave të njeriut.

E njëjta gjë vihet re edhe me të drejtën e këtij minoriteti për nivelin e kërkesave për të drejtat e tij. Bile, është fakt, pavarësisht se është për t’u ardhur keq, se në këtë rast edhe klasa politike e minoritetit etnik grek vetpërshtat qëndrimin e vet në përputhje të plotë me këtë klimë imponuese.

I së njëjtës natyrë, pavarësisht se shfaqet si diskriminim pozitiv, është dhe rasti i propozimit të fundit të Kryeministrit për garantimin me ligjin zgjedhor të një kuote fikse numri deputetesh që do të përfaqësojnë minoritetet (kujto grek)!!

Por lë ta trajtojmë në kendveshtrimin e analizës së nisur propozimin e Kryeministrit.

Bëhet fjalë për një propozim politik që prek thellë dhe në të gjitha përmasat parametrat e marrëdhënjeve dhe strukturën e tyre historike e politike si brenda vet komunitetit të minoritetit etnik grek, ashtu dhe ato midis këtij minoriteti dhe pjesës tjetër të shoqërisë. Dhe përseri, bile, as për një vendim të tillë historik dhe kaq të rëndësishëm nuk pyetet as minoriteti në terësi, as strukturat përfaqësuese të tij.

Së dyti jo vetëm që nuk pyetet minoriteti, por propozimi ka rrezik të zbatohet symbyllur dhe për interesa të ngushta të çastit pa pyetur për pasojat dhe përmasat e tyre.

Natyrisht, disa raste specifike, praktika dhe zgjidhje të ngjashme me propozimin e Berishës janë të njohura. Rasti më i freskët ai në Kosovë. Por ato nisen nga realitete konkrete që përfshijnë llojin dhe natyrën e marrëdhënieve midis shumicës dhe pakicës, raportet demografike, natyrën e shpërndarjës gjeografike etj.

Rrjedhimish janë logjike disa pyetje shqetësuese. Nga do niset Berisha për të përcaktuar “kuotat fikse të përfaqësimit të minoritetit në parlament”? Nga numri i deputeteve minoritarë grek, apo minoritarë në përgjithësi sot në parlament, pavarësisht nga partia që përfaqësojnë? Duhet të di që në parlamentin e sotëm ka gati 10 deputet me origjinë greke me parti të ndryshme!?

Do të nisët Berisha nga numri i deputëve të PBDNJ-së? Edhe në këtë rast ndodhemi përballë një antikapi tjetër. PBDNJ-shi fiton në ato zona që Berisha (dhe politika tjetër) ka parasysh si minoritet, as 20% të teresisë së votave që kjo parti siguron në mbarë vendin. Po ashtu, gjatë gjithë udhëheqjes së Dulës, PBDNJ-shi nuk nxorri asnjë deputet në zonat e pastra minoritare. Pra, deputetet e kësaj partie, o zgjidhen nga proporcionali me votat e anëtarëve të minoritetit grek në të gjithë Shqipërinë (dhe na rezulton se kjo pjesë është më e madhe se ajo në zonat me popullsi kompakte greke), o janë deputet minoritarë grek që zgjidhen me votat e minoriteteve të tjera, o zgjidhen me votat e votuesve shqiptarë....

Do të nisët Berisha nga zonat me popullsi kombakte minoritare greke? Edhe në këtë rast dalin një seri probleme. Psh, strukturat përfaqësuese të minoritetit grek nga njëra anë nuk duan të pajtohen me caktimin arbitrar nga shteti të numrit zonave minoritare dhe duan t'i zgjerojnë ato. (Rasti Himarë). Nga ana tjetër i drejtohen Brukselit me kërkesën që shteti shqiptar të abrogojë statusin arbitrar të zonave minoritare, pasi ai nuk i përgjigjet realitetit dhe as standartëve të të drejtave të njëriut të parashikuara në aktet ndërkombëtare. Edhe nëse problemi gjen zgjidhje në favor të interesave të minoritetit, është e sigurt se brenda territorit të tyre do të nisën veprimtarinë një seri "partish politike minoritare" që do të konkurojnë për fitimin e vendeve të paketës së dhenë.

Për të përcaktuar "kuotat fikse të përfaqësimit të minoritetit në parlament" Berisha do të nisët nga numri i popullsisë minoritare greke? Po cilit numër do t'i referohet? Atij të vitit 1989 të caktuar politikisht nga sistemi komunist e të lidhur ngushtësisht me popullsinë e 101 fshatrave me popullsi kompakte minoritare greke. Ky numër "harron" se paku faktin që minoriteti në vitet e diktaturës ka krijuar edhe një realitet tjetër pashmangërisht të konsiderueshëm përsa i përket numrit. Atë të migrimit për shkaqe të ndryshme në thellësi të territorit të vendit. Në këtë kategori duhet të përfshihen edhe ato disa mijra të tjerë që të detyruar, apo për të mbijetuar ndrruan kombësinë

Po ashtu, arsyetimi i mësipërm na promovoi tre argumenta lidhur me marrëdhënjet e minoritetit me pjesën tjetër të popullsisë. Egzistenca e një numri të konsiderueshëm minoritarësh greke, jashtë "republikës së vogël" të zonave minoritare, të integruar në mënyrë të shumifishtë me shoqërinë shqiptare, së dyti votimi i deputetëve minoritarë grek me parti të tjera jashtë "zonave minoritare" dhe së treti votimi i deputëve minoritarë me parti të tjera politike brenda zonave të pastra minoritare greke.

Në bazë të këtyre argumentave mund të bëjmë një koment të shkurtër, në formë pyetjesh. Vet minoriteti çfarë zgjidhje preferon? Së dyti. Zbatimi qoftë edhe apriori i këtij propozimi do t'i shërbejë integritetit të metejshëm funksional të minoritetit në shoqërinë shqiptare, apo shkëputjes me definicion marginalizimin e tij? Së treti. Mos vallë kjo zgjidhje në dukje elitare dhe e emancipuar do të shërbejë në fakt si një mjet për të ruajtur aq sa mundet situatën e dekompozuar politike në minoritet? Në lidhje me këtë mund të themi se propozimi i Berishë fsheh pretendime për përfitim politik. Serviret si joshje për të (ri)zgjuar interesin e Athinës për të dhe për garantimin e mbështetjes së deputëve të PBDNJ-së në ditët e vështira politike që pasojnë.

Mund të kuptohet gjithashtu lehtë gëzimi deri në gazëllim i Dulës dhe hidhërimi i faktorëve të tjerë politikë, që nuk i përkasin partisë së Dulës, në minoritetin grek. I pari se garanton mandatin e përjetshëm në parlament. (Prandaj ra mënjëherë dakort me këtë propozim pavarësisht se theksoi nën zë parakushtin demagogjik të regjistrimit fillimisht të popullsisë) (!) Të dytët se kjo formë e byrekut politik do të marrë parasysh vetëm Partinë e Dulës. Por nuk mund të mos themi se kjo situatë i shërbën çdo qeverie në Tiranë, pasi me këta politikanë minoritarë grek e kanë gjetur gjuhën sipas parimit mbushu xhepat që të harrojnë problemet e verteta të minoritetit.

Panajot Barka, për ABC, 21.05.2007

Nga Panajot Barka

## **Perëndimorët dhe tmeri pafund i vendit shkaktuar nga barbaria e politikanëve.**

17.07.2007

Po të ishte gjallë autori i poezisë filozofike “Në pritje të barbarëve” (e cila na përshkruan një shtet të mirëorganizuar por në krizë të thellë e që shikonte zgjidhjen tek ardhja e barbarëve), në kushtet aktuale të Shqipërisë me siguri që do të shkruante, “Barbaret mbëten vetëm”. Dhe do ta kishte fjalën për shtetarët dhe politikanët tanë, të cilët për hir të interesave të vogla meskine e çojnë këtë vend në udhëkryqe e qorrsokaqe pa rrugëdalje, të bindur se do të vijnë “perendimoret”, t’i marrin nga dora t’i kthejnë në “rrugë të mbarë”. E ata, në rol femijësh, të binden për pak kohë deri te zullumi i radhës.

Ky mentalitet u ka krijuar bindjen e të qenit faktorë politikë të pazëvendësueshëm në një vend, që, sipas mendimit të tyre, përbën qëndrën e botës e ku të gjithë ndërkombëtarët kanë përqendruar vemendjen e tyre për çdo moment.....

Por, “perëndimorët” nuk u duken kësaj here.... Dhe kjo ndodh për herë të parë, jo vetëm në periudhën post komuniste, por që atëherë kur doli në dritë çështja e shtetformimit të shtetit Shqiptar. Vertet, Oli Rehn, Doris Pack, Solana “kanë harruar” ku bie Shqipëria. Ambasadori i OSBE-s në Tiranë e kyçi derën. Ambasada Amerikane “është” pa ambasador. Diplomatet e tjerë Perëndimorë në kryeqytetin e shqiptonjave janë bërë memecë dhe gjithë sy e vesh ndjekin “zhvillimet” e ndodhura pa ata dhe mundohen t’i kuptojnë ato. Konstatojnë çvlerësimin ekstrem të politikanëve tanë, pa pikë integriteti moral e politik, pa pikë përgjegjesie për sovranitetin e shtetit dhe respektin e ligjeve. Perëndimorët as qajnë e as qeshin me tragjikomizmin e politikanëve tanë. Shikojnë me habi dhe venë në lëvizje gjithë intuitën për të kuptuar ku mbarojnë intersat personale dhe ku fillon respekti i ligjit dhe i shtetit, të kuptojnë raportet midis atyre që mendojnë, atyre që thonë, atyre që bejnë dhe atyre që duan këta qeratenj politikanë shqiptar. Habia shtohet kur secili nga tanët u shkon perendimorëve nga pas u qahet për kolegët e vet, ose flet për rrezikshmerinë e tyre po nuk u morrën parasysh nga perëndimorët “direktivët” e tij. Ose, arrijnë të kërcenojnë për destabilitet politik vendor e rajonal. Harrojnë ligjet, shtetin, kushtetutën.... interesat e verteta të vendit. Gjithçka me shpresë se do të tregohen me të devotshëm dhe më të besuar ndaj perendimit. Shpesh janë po ata, që deri dje të ngopur nga pushtetit dhe të etur për zullume politike me definicion ekonomik për vete dhe rrethin etij të ngushtë, i shikonin perendimorët dhe ndërkombëtarët si pengësë dhe ngatrestarë në “punët e brendshme” të shtetit....

Nga ana tjetër politikanët tanë kërkojnë të zbulojnë dhe çfarë kërkohet prej tyre nga Perëndimorët. Mjaft që të jenë të pëlqyeshëm për ta, pa në djall të shkojnë interesat e vendit... Priten gjatë direktivën për emrin e presidentit konsensual (një propozim i vjetër i perendimorëve për të kapërxyer zgjedhjet e parakohshme). Kryetarë partish, politikanë të thjeshtë, analistë, popull i thjeshtë e kishin kthyer në devizë që ky emer do të dalë nga “X” apo “Y” derë. Por nuk ndodhi. Dhe politikanët e një vendi i shquar në idololatrizmin e tij, prodhuan për kreun e shtetin një listë emrash me anonimatë. (Kuptohet, kushdo që të ishte nga këta të mund të përdorej lehtësisht për qëllimet e ditës dhe personale të politikës). Kalkulimet për president nuk kanë asgjë të përbashkët me postin primat të shtetit. Por shikohet qartë një pazar “gabi” që zbulon edhe më thelbin e politikës. Ndërgjegja dhe vullneti politikë i deputetëve dhe politikanëve tanë përcaktohet nga mënyrat se si do ta përdorë votën që të mund të mbijetojë në politikë apo të mbrojë interesat e veta ekonomike. Udhëheqësit politikë në mazhorancë kërkojnë



t'u imponojnë atyre mënyrën e votimit duke përdorur si mjet presioni dosjet e trasha me pislleqe e afera korruptive.

Por kurrë ata nuk mund të humbasin pikën e referimit që janë Perëndimorët. Pra “dëshirat” e tyre kërkojnë ta kalkulojnë me “vullnetin” e Perëndimorëve. Teza që u duket më e përshtatshme është ajo që nuk duhet të shkojë vendi në zgjedhje të parakohshme. Dhe këtë tezë e përkrah, bile më më fanatizëm edhe opozita. (Pavarësisht se edhe për këtë Perëndimorët heshtin.) Deri këtu arrin shtrëmbërimi i funksionit politik i opozitës. Një parti politike krijohet dhe synon të marri pushtetin. Opozita jonë edhe pse deklaron se e humbi pushtetin pavarësisht se ka më shumë vota se pozita, edhe pse gjithë ditën deklaron se kjo mazhorancë nuk qeverisë dot dhe e ka futur vendin në një qerthull krizash, edhe pse e akuzon mazhorancën se kërkon të nënshtrojë shtetin me pushtetin e vet politik, prap deklaron se është për shmangjen e zgjedhjeve të parakohshme. Madje duket se ka bindur edhe elektoratin me tezën se zgjedhjet e parakohshme nuk i duan as perëndimorët. Dhe nuk kupton se kështu është në kundërshtim me misionin e vet. Nuk e kupton se një sjellje e tillë do ta shndërrojë procesin e ringritjes së vet pas konsumit që pesoi në qeverisje, në një kalbje të ngadaltë dhe pa kthim. Fakti që në këto momente nuk vepron si opozitë por si një forcë që kërkon të shtyjë ditët me kompromise të vogla dhe arna politike, përbën një tregues domethenës.

Por, zgjedhje të parakohshme duket se i parapëlqen udhëheqësi i mazhorancës. Ai konstaton me kënaqësi se, në kushtet e një ligji elektoral lehtësisht abuzues dhe të “indiferencës” së Perëndimorëve, zgjedhjet do t'i rifitojë me mënyrën që di ai dhe që e garantojnë predispozitat e lartëpërmendura. Në këtë mënyrë, ai shtyn pushtetin edhe katër vjet të tjera. Madje, pas kësaj mund t'i fal opozitës presidentit konsensual nga radhet e saj dhe i heq çdo të drejtë për t'u ankuar. Fitorën e dytë radhazi e përdor si argument për të bindur faktorët e tjerë për kredibilitetin e vet politik. Më këtë rast heq qafe të gjithë opozitarët e brendshëm dhe siguron prej të tjerëve devotshmeri që të ketë duart e tij më të lira për çdo veprim.

Por zgjedhjet e parakohshme përbejnë një domosdoshmeri. Jo thjesht si një fakt për t'u krijuar bindjen politikanëve tanë se nuk është e vërtetë se vullneti i tyre i pistë qëndron mbi ligjin dhe kushtetutën. Zgjedhjet do të shërbëjnë si një mjet për të shoshitur këtë sistem politik, për të krijuar bindjen në popull se ka në dorë ai të përcaktojë se kë zgjedh për ta udhëhequr dhe jo manipuluar të vullnetit të tij zgjedhor. Zgjedhjet vertet mund të duken si një fund i tmerrshëm, por është e sigurt se e shpetojnë vendin nga një tmerr pa fund. Dhe pikë së pari nga ata politikanë që për gjithë tranzicionin e monopolizuan politikën dhe e aplikojnë si tmerr pa fund. Ky lloj tmerrri na shfaqet më së shumti në marrëdhëniet që ka krijuar shteti i politizuar i kësaj klase politike me qytetarët e vet. Ky lloj shteti në vend të mbrojtësit të interesave të qytetarit është kthyer në kundërshtar dhe shfrytëzues të tij. Shtetarët që përfaqësojnë këtë shtet po vjedhin haptas vlerat që qytetarët po krijojnë në emer të shtetit. Dhe po ky shtet i shtetarëve politikë nuk përbën asnjë garanci dhe siguri për qytetërit e vet. Nuk i garanton gjërat elementare për të jetuar, punën, ujin, dritën, nuk i garanton qetësinë dhe barazinë para ligjit. Tani po i heq të drejtën dhe për të qenë pjesëmarrës në zgjedhjen e fatit të vet.

P. Barka. 17. 07.2007 Për gazetën ABC

Nga Panajot Barka

## **Tezat pro dhe kundër “Vorioepirit” frymëzohen nga të njëjta qendra, u shërbëjnë të njëjtave qëllime, por nuk mund të sfidojnë realitetin diakronik të Epirit**

08.08.2007

Para paka ditësh, në fshatin Sotirë të Dropullit të Sipërm të Gjirokastrës, u zhvillua festa tradicionale fetare e emrit të fshatit. Kjo festë, përveç anës tradicionale dhe pjesëmarrjes të përhershme të gjerë, merr rëndësi se ka fituar statusin e festës ku evidentohen qëndrime të karektierit politik e etnik në varësi të përfaqësimit politik të minoritetit grek.

Sivjet në këtë festë merrnin pjesë përfaqësues të strukturave të shtetit shqiptar, përfaqësuar nga pjesëtarë të minoritetit grek dhe shqiptarë, diplomatë nga Shqipëria e Greqia, Kryetari i ri i sapozgjedhur i Fedaratës Panepirote të Amerikës, POAKA, Kristos Galicis, Kryetari i Këshillit Panepirot Nikollas Geixh etj.

Në fjalimet politiko-etnike u vu re prirja për të promovuar identitetin e minoritetit etnik grek në Shqipëri nëpërmjet idesë së Vorio Epirit. Përfaqësuesit e OMONOIA-s dhe të PBDNJ-së e incuan këtë klimë fjalimesh për të rritur aksionet politike dhe fituar pak nga terreni i humbur në aspektin e mbrojtjes së interesave etnike të minoritetit grek, të këmbyer me interesat personale që rrjedhin nga pjesëmarrja në qëveritë e majta dhe të djathta në Shqipëri. Përfaqësuesit e strukturave Panepirote bënë edhe një herë detyrën. Treguan se ata nuk e “harrojnë dhe vazhdojnë luftën për helenizmin e Vorio Epirit”. Ndërkohë të kënaqur dhe pa asnjë reagim u dukën edhe përfaqësuesit shqiptarë të strukturave shtetërore shqiptare pjesëmarrës në festë. Pra, të gjithë degjuan fjalimet, hengrën, pinë dhe kërcyen.... deri në djersitje.

Ndjesia e parë që të krijon një skenë e tillë lidhet me risin e njohur të përsëritjes së historisë në formën komike. Dhe ja pse. Nëse do të supozojmë se në këtë miting-festë për shkak të qëndrimeve të ndryshme, deri në të kundërta në lidhje me “Vorio Epirin”, kishim dy palë, të dyja rezultuan të kënaqura, pavarësisht se nga drejttime të ndryshme.

Të parët, përfaqësuesit “Vorio-ipirotas”, ishin të kënaqur se folën edhe një herë për Vorio Epirin. Dhe jo dokudo. Por, në ambjent me përfaqësues të strukturave me peshë në probleme të helenizmit,(!) ku ishin të pranishëm dhe autoritete shtetërore shqiptare, por edhe shumë bashkëkombas. Për ta nuk ka rëndësi se çfarë thanë për Vorio Epirin. Mendimi i tyre politik as që bëhet fjalë të lidhet me Vorio Epirin në aspektin gjeopolitik, ashtu si realiteti i veprimeve të tyre politike nuk i shërbën në asnjë moment interesave dhe të drejtave të minoritetit etnik grek. Refërimi te termi patriotik i “Vorio-Epirit” është për ta një “akt heroik” që u siguron mbijetesë politike në shtetin shqiptar (!!)

Pikërisht, në këtë antikap buron kënaqësia e palës tjetër. Mendimi i tyre është lehtësisht i lexueshëm. “Lë të lëhin si qentë Henës. Nuk kemi pse të kemi frikë. Udhëheqësit e tyre politikë janë tanët. Mirëqënia dhe egzistenca e tyre politike janë të lidhuara me pesëqindë fije me ne. Deklarata për Vorio-Epirin, pa asnjë objektiv real nuk na bën dëm. Përkundrazi. Kjo për faktin se ata në opinionin e tyre publik bëhen më pak dyshimtë për shërbimet reale ndaj nesh.”-Thotë mendimi i tyre

Nga ana tjetër ky rast shërbën për të vërtuar se deklaratat dhe qëndrimet nacional-shashkore të udhëheqësve “Vorio-epirot” bëhen nën kontrollin dhe në shërbim absolut të strukturave të caktuara të mjedisit shqiptar. Është konstatuar se promovimi i deklaratave për Vorioepirin nga strukturat udhëheqëse të minoritetit,

ndodh atëherë kur janë të interesuara pikërisht këto struktura. Qëllimi është të shkaktojë zëmeratën nacionaliste shqiptare jo mbi këta “udhëheqës”, por mbi komunitetin e minoritetit etnik grek që ky të humbas aftësinë reaguese edhe për të drejtat e tij themelore. Në rast se ndodhin deklarata “vorio-epirote” jasht këtij kontrolli, atëherë po këta udhëheqës nxitojnë të distancohen nga këto “ngjarje heretike dhe pa koshiençë”

Kujtojmë për këtë dy momente tipike. Udhëheqja politike zyrtare e minoritetit grek para pak muajsh nuk mori pjesë në veprimtarinë promovuese të librit për gjyqin e të pestëve të OMONIA-s. Kishte marrë njoftim se shprehja e përdorur aty se “Gjyqi i të pesteve stacion në luftën dhe përpjekjet e helenizmit Vorio-epirot për të drejta e tij”, do të shkaktonte zëmeratën nacionaliste të medjave shqiptare. (!!)

Ose kujtojmë mënyrën e reagimit të udhëheqës politikë të OMONIA-s & PBDNJ-së ndaj deklaratës së Bollanos. Eksponentë të lartë të PBDNJ-së u distancuan me nxitim deri edhe në parlament duke e dënuar ashpër këtë deklaratë. Më komik është qëndrimi i udhëheqës së OMONIA-s. Në numrin e fundit të gazetës së saj u botua deklarata zyrtare e kësaj organizate që atakonte organet e medjas shqiptare se kishin sajuar deklaratën. Në një artikull tjetër të botuar po në atë faqe gazete thuhej se Bollano me deklaratën e tij bëri detyrën e lartë historike dhe patriotike (!!)

E ndërsa ndodhin këto në kampin e minoritetit etnik grek, apo në lidhje me të, në anën tjetër, sidomos në atë medjatike shqiptare, ndodhin qëndrime krejt të tjera. Vihet re një përpjekje e stërmundimshme për të vërtetuar se Epiri (jo vetëm Vorio Epiri) ose nuk egziston fare si identitet historik e real gjeopolitik, etnik e kulturor, ose për të vërtetuar të paktën që si i tillë nuk ka lidhje me Greqinë. Pasi mendojnë se ia dolën mbanë, mbeshteten në këtë tezë për të thenë se përderisa nuk është greke është e linjës iliro-shqiptare.

Unë mendoj se të gjitha ketegoritë e përmendura dhe sjelljet apo argumentat e tyre për Epirin u ngjajnë vertet gjembaçeve të goricës poshtë rotave të trenit. Epiri është një realitet historik dhe një identitet gjeopolitik nga më interesantet dhe më të lakmueshëm. Ndërgjegja historike e Greqisë që nga kufijtë e mitologjisë, e ka cilësuar si djep të kulturës greke. Këtu nisën endrrat dhe realitetet për perandoritë e mëdha të Perendimit dhe të Lindjës me Piron dhe Aleksandrin e Madhë. Epiri kishte aftësinë të përqendronte në vetvete fuqinë e Perandorisë Bizantine të shëmbur nga kryqëzatat. Jo me kot Gjergj Kastrioti në fillim dhe Ali Pasha me vonë ripërsëritën, secili me mënyrën e vet karakterin e mevetësisë se këtij identiteti, (pavarësisht nga përberja etnike). Nuk është rastësi që përpunimi i ideologjisë se re kombëtare greke e fundit të shekullit XVIII i ka rrenjtë e veta në këtë trevë. Ashtu si disa dekada me vonë nis pikërisht këtu platforma ideologjike e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Kjo trevë me rendësi të jashtëzakonshme gjeopolitike si udhëkryq midis Lindjes dhe Perendimit ka sfiduar lakmitë dhe shkatërrimet e imponuara dhe u ka paraprirë zhvillimeve globaliste, të hapjes e të bashkëjetesës së kulturave e etnive, jashtë paragjykimëve mesquine nacionaliste.

Shpesh ne i kerkojmë Epirit kufijtë gjeografikë dhe etnokulturor. Ato mund t'i gjejmë po t'u referohemi edhe sot elementeve të mbartura nga lashtësia e vet mitologjike. Kufijtë e Epirit mbarojnë aty ku akoma edhe kësaj dite komunitetet (fshatrat apo qendrat e tjera të banuara) e nisin organizimin e tyre urban me qendër një pemë (kryesisht rap), element që të çon tek pema-orakull i Dhodhonit. (Edhe pelerina e Skendërbeut paraqitur në gravuarat e kohës, mbart të pikturuar fryte dhe gjethe nga kjo pemë-orakull, ashtu si koka e dhisë në krye të përkranarës së tij është e lidhur me këtë identitet) Kufijtë e Epirit mbarojnë aty ku në këngët popullore, pavarësisht nga gjuha, zenë vend përcaktues roli i pemës dhe i zogjve, (që prap na çojnë tek Orakulli i

Dhodhoni). Kufijtë e Epirit fillojnë dhe mbarojnë aty ku shtrihet kënga polifonike tre-katër zëreshe, pavarësisht nga gjuha dhe etnia.

E pra, kur këtë identitet, nuk e zbehu historia dhe nuk e shoqti mania shkatëruese e perandorive nga më të mëdhatë, pse rrinë dhe harxhojnë energjitë disa kalemxhinj axhami? Pse me këtë menyrë zvogëlojnë shtatin e tyre intelektual e akademik të gjitha ata që i kundërvihen këtij realiteti. Globalizmi botëror dhe Evropian do ta rivendos Epirin serish në rolin e vet shekullor. Realiteti i rrjetit rrugor ndërkombëtar që përshkon trupin e Epirit, i kryqëzuar me atë detar për të sjell më afër Perendimin me Lindjen përbën parathënjën sfiduese për të gjithë ata që mendojnë dhe veprojnë ndryshe.

P. Barka për gaz. ABC datë 08.08.2007

Nga Panajot Barka

## **Athina-Tirana rrënimi i minoritetit dhe roli i Dulës.**

24-31.10.2007 - 03.11.2007

Në vendin tonë nuk është as i huaj e as i ri fenomeni i përvetësimit të interesave të çdo lloji të komunitetit nga përfaqësuesit e tij të çdo niveli, veçanërisht politik. Nga kjo risi nuk ka shpetuar as komuniteti i minoritetit etnik grek. Veçse këtu gjërat kanë shkuar shumë larg. Lidhshipi politik i minoritetit po e marginalizon atë, me pasojë deformimin e raportëve dhe marrëdhënieve me politikën zyrtare të Tiranës dhe e rolit të këtij minoriteti në marrëdhëniet midis Tiranës dhe Athinës.

**I. Një nëntitull për aspektin e parë do të qe: Me 2005, pak para zgjedhjeve, Berisha i kërkoi të falur minoritetit grek, për politikën e ndjekur ndaj tij në vitet 1992-1997. Pas zgjedhjeve, me bekimin e tij, po këtë politikë ndaj minoritetit e vazhdon Partia e të Drejtave të Njëriut.**

Po servirim me posht argumentat. Këto javët e fundit një numër aspak i vogël familjesh nga minoriteti grek u larguan për në Greqi. Dy janë arsyet: Problemet ekonomike. (Bëhet fjalë për rrenimin e biznesëve të vogla apo të mesme të zhvilluara gjatë qeverisjës së PS-së) Arsyja e dytë lidhet me gjendjen mjerane të shkollave në gjuhën amtare.

Në planin ekonomik duhen parë me vemendje dy arsye të karakterit të veçantë. Së pari bëhet fjalë për imponimin e biznesit në minoritet për të konkuruar në treg në kushte të pabarabarta. Përballë informalitetit ekonomik atij i duhet të konkurojë duke respektuar ligjin. Kjo nuk lidhet thjeshtë me kulturën, por me nevojën për të shmangur hakmarrjen e shtetit që e përdor ligjin për përfitim politik partiak. Qëverisja e tanishme e shikon faktorin ekonomik të zhvilluar në kohën e socialistëve si kundërshtar politik që duhet eliminuar. E veçanta është se në minoritetin grek nuk konsiderohet kundërshtar politik i PD-së në pushtet, por i aleatës së vet, Partisë së të Drejtave të Njëriut. (!) Pra një gjueti shtrigash të paprecedentë ku në rolin e viktimave dhe përndjekësve gjen vetëm minoritarë grek. Qëllimi dhe pasojat nuk besoj se kërkojnë komente të metejshme. Komenti i vetëm është se gjendja ekonomike e lidhshipit të PBDNj-së është në rritje galopante.

Marrim aspektin e dytë, atë të shkollave publike në gjuhën amtare. Siç dihet, kryetari i Partisë së të Drejtave të Njëriut, V.Dule, për të qenë më “bindes”, më “kërkues” dhe më “konkret”, në koalicionin e ri alla Xhuveli me PD-në, nënshkroi një memorandum me Berishën. Nëpërmjet këtij “dokumenti”, ndryshe nga marrëdhëniet e Dulës me Nanon, Berisha angazhohej se do të përmbushte disa nga kërkesat themelore të minoritetit. Memorandumi u bë i njohur vetëm në Athinë për të treguar se “Berisha ka ndryshuar”, por edhe për të “justifikuar” kreun e PBDNj-së për aleancën e re. (Nuk dua këtu t’i rikthehem demit moral që i shkaktoi minoritetit etnik grek kjo aleancë e lidhshipit të PBDNj-së. Bëhet fjalë për një imazh krejt të deformuar të një minoriteti si gjithmonë të përkedhelur dhe të gatshëm për të përfituar, madje duke lepirë aty që vet ka pështirë. Pra, një mentalitet që karakterizon lidhshipin por që i dedikohet gjithë komunitetit.)

Pra, një nga pikat në memorandum ishte edhe zgjidhja e problemit të shkollave në gjuhën amtare. Faktet tregojnë se dy vitet e fundit nxënësit e arsimit publik të detyrueshëm të minoritetit grek, nuk kanë tekste në gjuhën amtare dhe i marrin mësimet me shënime si në shek e XIX. Programet dhe planet mësimore të këtyre shkollave nuk kanë asnjë përputhje me sistemin e ri 9-vjeçar. Mësuesit japin mësim nën kërcenimin se do të pushohen nga puna nëse nuk tregojnë devotshmeri politike ndaj lidhshipit të

PBDNj-së..... Pasoja është e thjeshtë dhe e dhimbshme. Disa dhjetra femijë u larguan edhe këtë vit për të vazhduar shkollat në Greqi.

Ironia nuk mbaron këtu. Kryetari i qeverisë i deklaroi të shtunën e shkuar Komisionerit të Këshillit të Europës për të Drejtat e Njeriut, Thomas Hammarberg se “janë arritur standartet e OSBE-së, në arsimimin fëmijëve të minoriteteve”. (!) Ndërsa kryetari i PBDNj-s Dule shfaqet medjave me poza opozitari. “Kritikon” qeverinë për paefekshmeri dhe kërkon rikombosim të saj. Vë levat e tij “për të kercenuar” Berishën se do të iki nga koalicioni:- lëvizje politike të ngjashme si dy pika uji me atë të periudhës së koalicionit me Nanon. Qëllimi qartësisht i lexueshëm. Të përfitojë sa më shumë nga pushteti, ose të për t’i imponuar Berishës monopolin e përfaqësimit të minoritetit në qeverisje, ndërkohë që Berisha, si Nanua, kërkon të krijojë korentin e vet politik në minoritet me njëzëz që i ngriti në pozitë Dulja. Është pikërisht ky realitet që lë zbuluar Berishën para Komisionerit të Këshillit të Evropës. Berisha për të treguar “nivelin e lartë” në respektimin e të drejtave të minoritetit grek, i permendi Hammarberg-ut pikërisht pjesëmarrjen e disa minoritarëve, miq të Dulës dhe të Berishës, në qeveri.

Komenti përseri i tëpërt.... Por mund t’i kujtojmë këtij lidhshipi një ngjarje nga e kaluara me jehonë deri në ditët tona. Në një fshat të sotëm minoritar grek një familje shiti tokën te pushtuesit Otoman. Stërparaardhësit e saj vuajnë ende sot përbuzjen për këtë akt të stërparaardhësve.

**II.** Për aspektin e dytë, atë në lidhje me rolin e minoritetit në marrëdhëniet midis dy shtetëve, nuk zgjodhëm nëntitull. Por mund të vemë re psh se Athina zyrtare partneritetin e vet me Shqipërinë po e mbështet dhe e zhvillon mbi dy faktorë. Në atë tradicional që është minoriteti etnik grek dhe në atë aktual që është prezenca e drejtpërdrejtë e faktorit grek në kuadrin e integrimin e globalizmit kryesisht ekonomik. Nuk mund të mos vemë re gjithashtu se faktori i parë, minoriteti po dethelbezoet. Arsyen themelore për këtë duhet ta kërkojmë te fakti se Athina ka humbur besimin e partneritetit te lidhshipi i minoritetit. Madje, gjithënjë e më tëpër po i kumton edhe Tiranës se nuk ka në Shqipëri ndonjë përfaqësues, apo zëdhënës të vetin. Aq me tëpër nuk mund të përcaktojë marrëdhënjet midis dy shtetëve qëndrimi i Tiranës ndaj një faktori të tillë, qoftë ky individ apo forcë politike. Kjo po e defaktorizon lidhshipin e PBDNj-së që abuzonte dhe përfitonte, si në emer të minoritetit etnik grek, ashtu edhe nga një rol i paqenë përfaqësuesi të Athinës.

Po ashtu po vertetohet se ato gjera që kërkon të arrijë Athina me Tiranën, i arrin pa ndërmjetës të këtij niveli. Bile kjo është e vlefshme edhe për ato kërkesa që lidhen me vet minoritetin grek.

Argumenti më i freskët përbën inaugurimi i godinës së re të shkollës Arsakeio në Tiranë në fillim të tetorit. U bë nga vet ministri grek i arsimit me praninë e dhjetra autoriteve nga shumë fusha të shoqërisë greke. (Kuptohet, bëhet fjalë për një inisiativë që lidhet drejtpërdrejt me identitetin civilizues të Greqisë që nga lashtësia,- eksportimi i kulturës dhe i dijës.) Në këtë ceremoni u vu re roli fare anësor i lidhshipit të PBDNj-së dhe OMONIA-s. Krahasimisht nuk mund të mos vemë re se asnjëherë Athina zyrtare nuk u impenjua qoftë edhe me nënfishat ekstreme të këtij interesi, psh për fatin e shkollave dhe arsimit në gjuhën amtare në minoritetin etnik grek.

Ta marrim problemin nga një pikë tjetër veshtrimi. Para pak kohësh, Ministri i Jashtëm Basha rikonfirmoi deklaratën e ambasadorit të Greqisë në Tiranë për ratifikimin nga parlamneti grek të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit të Shqipërisë në BE.

Si një nga përkrahësit e vijës që minoriteti grek asnjëherë nuk duhet të bëhet pengesë në rrugën e integritimit Euroatlandik të vendit, kuptohet që nuk jam as kundra këtij vendimi të Athinës. Por unë dua të kujtojë këtu deklaratat e kahërshme të Presidentit të sotëm të Republikës Greke, zotit Papulias dhe autoritetëve të tjera greke se rruga e

Shqipërisë për në Evropë kalon nga respektimi i të drejtave të minoritetit grek në Shqipëri. Pyetja tani shtrohet: Çfarë ndryshoi pozitivisht në respektimin të drejtave të këtij minoriteti që pala greke merr përsipër ratifikimin e MSA!? Mos vallë Athina ka parasysh përkeqësimin e gjendjes në shkollat e minoritetit, regjistrimin e pa kryer të popullsisë me të drejtën për vetëdeklarimin e kombësisë, veshitësitë juridike në rritje për përfitimin e kësaj kombësie në gjykatat, nxitjen e përkeqësimit të situatës ekonomike dhe të marrëdhënjeve midis anëtarëve të këtij minoriteti, ndërlikimin e metejshëm të statusit të pronësisë?

Si përfundim do të thoshim se ka një prirje për shpërfillje dhe shpërberje të integritetit etnik e shoqëror të minoritetit grek në Shqipëri. Pavarësisht nga mjeti i gjetur për ta arritur këtë, siç është Lidërshipi politik i këtij minoriteti, (që nuk mund të përmblihet totalisht tek PBDNj-ja dhe OMONIA), asnjë nga palët nuk del e fituar nga arritja e qëllimit në fjalë. Shqipëria në Jugun e vet do të dalë shumëfish e humbur nga prishja e raportëve etnikë, shoqëror e ekonomikë në këtë pjesë të vendit që në shekuj i kanë kontribuar integritetit e stabilitetit, përparimit dhe zhvillimit të rajonit. Greqia e Shqipëria së bashku do të humbasin një partner real, historik e natyror të pazëvendësueshëm në marrëdhëniet midis tyre, ndërsa Greqia përveç tyre do të humbas, minoritetin e vet etnik, trashëgimtarin natyror të kulturës së vet dhe në kuadrin e rajonit më të gjerë, një faktor me rëndësi për ruajtjen e ekuilibrave gjeopolitike . FUND 24-31.10.2007 Ubotua më 03.11.2007

Nga Panajot Barka

## **Sfidat e vizitës së pritshme të Presidentit Topi në Athinë.**

07.11.2007 /10.11.2007

Kabineti i Presidentit të Republikës ka ditë që punon për axhendën e vizitës që zoti Bamir Topi do të realizojë me 26-27 nëntor në Athinë. Vizita është fiksuar pas ftesës së homologut grek Karolos Papulias.

Ftesa e Papulias për homologun Topi ka disa arsye që duhen vlerësuar. Së pari Karolos Papulias është fiksuar në historinë moderne të marrëdhënieve midis dy vendeve si politikani që lëviz portat e ndryshkuara në komunikimin midis dy vendeve. Kjo nuk lidhet vetëm me inisiativat e tij në vitet 1985-87. Në kujtesën diplomatike të të dy vendeve duhet shënuar inisiativa e tij për të çarë akullin më të rëndë në marrëdhëniet midis dy vendeve, atë të periudhës 1993-95. Po ashtu, periudha e tanishme nuk justifikon deklaratat për nivelin “shumë të mirë” deri “në të shkëlqyer” në marrëdhëniet midis dy vendeve. Disa vizita ministrash të qeverisë greke në Tiranë, duke përfshirë atë të mbrojtjes dhe të jashtëm, janë anuluar. Ndërsa kryeministri Berisha dhe zyrtarë të tjerë të Tiranës mëzi i kanë shkëputur Athinës disa ftesa për disa takime dhe vizita të nivelit limonadë. Tregues i këtij realiteti përbën edhe vonesat e pajustificuara për nënshkrimin e marrëveshjes kulturore midis dy vendeve.

Së dyti dhe po në këtë kuadër, Papulias, si një politikan që mishëron vlerat e kulturës perëndimore të gërshetuara me vlerat humane të një gjitoni që mençuria nuk e lëjon të mbetet peng i inateve nacionaliste ballkanase, me këtë ftesë do të kapërcejë shijen e keqe që la anulimi i detyruar i takimit informal me presidentin Moisiu në fillim të nëntorit të 2005.

Së treti, Papulias fton Topin në Athinë se në aspektin diplomatik e protokollar të reciprocitetit, mbeti e pakthyer vizita që paraërdhësi i tij Stefanopollos bëri në Tiranë e minoritet në tetor të vitit 2004, kuptohet pas ftesës së presidentit të atëhershëm Moisiu. (Edhe ky fakt është një tregues i rrallimit drejt varfërisë në shkëmbimin e vizitave të niveleve të ndryshme midis dy vendeve). Pra, Karolios Papulias me ftesën e tij drejtuar Topit ndërmerret edhe një herë inisiativën për të ngrohur komunikimin midis Athinës dhe Tiranës në nivelin më të lartë.

Por, jashtë vullnetit të mirë a është e thjeshtë arritja e një axhende në shërbim të këtij qëllimi? E verteta është se kabinetet respektive punojnë me intensitet por pa arritur të gjejnë formulat e duhura për kapërximin e situatave reale.

Tirana, për shkak të Kosovës, ka kohë që manifeston ndjesinë e të qenit lokomotiva e zhvillimeve në Ballkan, e cila e terheq gadishullin drejt zgjidhjes së të gjitha ambicjeve etnike të saj. Në këtë kendveshtrim, Tirana manifeston hapur rezervat që ka ndaj Greqisë. Në bazë të formulës së vjetër, të boshtit ortodoks, të trashëguar që nga periudha e pushtimit Otoman, Greqia vazhdon të klasifikohet nga Tirana si aleate e Beogradit. Nuk mund të mos vihet re se këto rezerva janë krejtësisht të pajustificuara për realitetin grek, aq me tëpër po të kemi parasysh pozitën dhe statusin e Greqisë në strukturat dhe organizmat ndërkombëtare.

Ky mentalitet, i kultivuar me forcë nga sistemi komunist për qëllime ideologjiko-nacionaliste të njohura, është kthyer në qëndrim tabu dhe të politikës së sotme zyrtare në Tiranë. Ai nuk ndyshon edhe kur bie ndesh me interesat më të gjera të Shqipërisë. Është pikërisht kjo tabu që nuk e lë psh, Tiranën të pozicionohet në problematikën aktuale në marrëdhëniet e Athinës me Shkupin (në lidhje me emrin). Shqipëria dhe shqiptarët e kësaj republike, të cilët, besoj se nuk kanë lidhje me pretendimet sllave për Maqedoninë e Aleksandrit të Madh, për interesat e tyre, kuptohet kombëtare, mund të investonin në këtë rast në një aleancë me Greqinë. Kjo vertet nuk ndodh, por as



ndihmon në krijimin e një klime esencialisht miqësore, si në vizitën e zotit Topi në Athinë, por edhe më gjerë midis dy vendeve.

Ka edhe të tjera gjera që e bejnë vizitën e Topit në Athinë jo aq korresponduese me qilimin e pritjes shtruar në aeroport dhe protokollin ekstrem të vizitës së kreut të një shteti mik.

Psh. Zoti Papulias ka një histori të gjatë me eshtrat e ushtarëve grek renë në luftën Italo-greke në tokën e shtetit shqiptar. Ai manifestoi me veprime konkrete ndjeshmërinë që lidhet me krenarinë kombëtare greke në kohrat moderne. Me emrin e tij lidhen fillimet e interesimit të palës greke që me 1981-82 dhe vëçanërisht me 1985-87. Por metodat komuniste të përdorura në verën e vitit të shkuar me skandalin e stisur të eshtrave në Kosinë të Permetit, nuk mund të lenë pa hije vizitën e Topit në Athinë, pavarësisht se do të shprehet apo jo Papulias për këtë çeshtje. Fakti që Shqipëria me paranoja nacionaliste të komunizmit shkel konventën e Gjenevës për të renët e ushtrive të huaja në shtete të tjera dhe njëkohësisht aspirojnë një vend në NATO dhe BE, i heq të drejtën morale Greqisë për një përkrahje aktive në favor të kësaj asperate.

Po ashtu, problemet që lidhen më të drejtat e minoritetit grek në Shqipëri fituan kohët e fundit një përmasë të re. Sipas medjave greke, presidenti i Greqisë Papulias, priti këtë javë një përfaqësi të shoqatave të minoritet grek që veprojnë në Athinë. Takimi ndodhi fill pas një protestë që këta të fundit kishin bërë para ambasadës shqiptare në Athinë. Protesta, e para e këtij lloji, lidhet me një përmasë të re të shkeljës së të drejtave të minoritetit grek në Shqipëri e që lidhet me nenin 16 të “Konventës Kuadër të KE për mbrojtjen e minoriteteve”. Fjala është për masa dhe veprime të shtetit apo segmenteve të tij që çojnë në ndryshimin e përbërjes së popullsisë në zonat e banuara nga përsona që u përkasin minoriteteve. Është fakt që për më shumë se dhjetë vjet, gjykatat dhe institucione të tjera kompetente shtetërore me dokumenta të falsifikuara dhe procedura të dyshimta po u kthejnë “ish pronarëve” me kombësi shqiptare, dhjetra mijra hektarë pyje, kullota dhe toka bujqësore që i përkasin komunitetit të minoritetit grek. Fshatra të tera, sidomos në Sarandë e Delvinë, dikur me popullsi homogjene minoritare greke, banohen tani, në terrësi, apo në shumicë, nga shtetas me kombësi shqiptare. Sipërfaqe të tera toke nga më pjelloret, në zonat me popullsi kompakte minoritare greke, po në këto rrethe, projektohen t’u jipen të ardhurve nga zonat malore të Jugut apo të Veriut të Shqipërisë.

Ky problem, tanimë të përdorur i mbrehtë dhe shqetësues për Athinën, u shtohet atyre tashmë të njohura siç janë, arsimimi në gjuhën amtare, lëjimi i informimit në gjuhën amtare dhe me mjete të kombit am, regjistrimi i popullsisë etj.

Tiranës zyrtare kësaj here nuk i vjen më në ndihmë mbulimi i kësaj problematike (për arsye personale) nga ana e udhëheqjes politike të minoritetit grek. Argumenti klishe e përdorur kohët e fundit nga Tirana zyrtare se për nivelin e lartë të respektimit të të drejtave të minoritetit grek në Shqipëri përbën fakti i pjesëmarrjes së përfaqësuesve të tij në qeveri, nuk mund të përdoret nga Topi në Athinë. Për këtë argument ka një përgjigje domëthenese, se, në kohën e diktaturës komuniste kishte më shumë se tani përfaqësues nga minoriteti grek në administratën e shtetit.

Presidenti Topi, i cili, pas nënshkrimit të pritshëm të kërkesës për shkarkimin e kryeprokurorit, ka rastin të paraqes profilin evropian të kryetarit të shtetit shqiptar, do ta ketë të veshtirë të hap në Athinë dosjen propagandistike nacionaliste të servirur kohë pas kohe në opinionin publik shqiptar. Në këtë rast atij do t’i duhet ta realizojë vizitën i ndodhur midis dy zjarrëve. **FUND** 07.11.2007. U botua me datë 10.11.2007

Nga Panajot Barka

## **Shteti nga administrues i vlerave të krijuara nga shoqëria në grabitës të tyre nga përfaqësuesit e tij në pushtetin politik (ekzekutiv)**

15.11.2007-17.11.2007

Pa pretenduar rolin e njohësit të shtetit po përpiqem të vë re disa fenomene që po trondisin në mënyrë të pakthyeshme raportin e qytetarit, si faktor shoqëror, me institucionin e shtetit në vendin tonë.

Së pari faktori shoqëror është indiferentë ndaj menyrës se si shteti administron vlerat e krijuara nga ai. Shteti bën të kundërtën e detyrimit të vet përta i përket kohëzisionit dhe ndërveprimit qytetar të komunitetit të nënshtetasve të tij.

Së dyti Shteti nga detyrimi i natyrshëm për të rregulluar marrëdhënjet shoqërore nëpërmjet respektimit të ligjit, ose më sakt për t'u venë në shërbim të faktorit shoqëror që respekton ligjin, është kthyer në produkt i shkelësve të ligjit dhe për pasojë në funksion të tyre.

Dihet që shteti, si institucion, ka një mision në shoqëri. Të administrojë vlerat e krijuara nga ajo, si individë dhe komunitet, dhe t'i vë ato në shërbim të këtij komuniteti, ta ndihmojë në përparimin e tij, gjithmonë në konceptin e së terës, të komunitetit.

Për mbarëvajtjen e këtij funksioni instalohen struktura dhe mekanizma kontrolluese që nuk lejojnë prishjen e këtyre raportëve dhe sidomos nënshtrimin e shtetit nga pushteti politik (ekzekutiv). Në aspektin institucional këto mekanizma presupozojnë ndarjen e pushteteve.

Në aspektin shoqëror funksioni kontrollues sigurohet nëpërmjet veprimit të komunitetit të organizuar në organizata, sindikata, OJQ, medja, forumet e ndryshme. Në një demokraci të vertet vihet re një bashkëveprim, ose ndërveprimi i të dy faktorëve për të ruajtur, konsoliduar dhe garantuar natyrën dhe funksionin e shtetit. Ndërsa, nëse vihet re dobësimi i funksionimit të mekanizmit kontrollues institucional, veprimi kontrollues i strukturave shoqërore forcohet në përpjestim të zhdrejtë.

Tek ne ndodh e kundërta. Komuniteti tregon se nuk është i ndërgjegjësuar se pjesën kryesore të parametrave jetësore, si në aspektin shoqëror dhe individual, duhet t'i sigurojë shteti. Nuk kupton se këto shërbime nuk duhen pritur si veprim human i shtetit. Aq me keq i përfaqësuesve të tij. Por si detyrim që rrjedh prej faktit se shteti në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të terthortë i thith këto vlera si pjesë e kontributit individual, përt t'i shndërruar ato në vlera për të gjithë shoqërinë, zhvillimin dhe ripërteritjen e saj. Në këtë kuptim, komuniteti i individeve nuk e kuptojnë se sigurimi i energjisë, i ujit, ruajtja e shëndetit, arsimimi, garantimi i veprimtarisë prodhuese, i pronës, i dhëniës së drejtësisë, i sigurisë, i infrastrukturës, nuk përbëjnë vlera të shtetit, as të krijuara mirëfilli prej tij e as për administrim a priori nga përfaqësuesit e tij. Nuk kupton se ai si individ ia "jep" shtetit këto vlera në mënyrë individuale dhe duhet t'i kerkojë ato shtetit në grup dhe në komunitet duke përdorur të gjitha format demokratike. Ndryshe funksioni i shtetit po kthehet në qëllim në vetevte, ose, siç po ndodh realisht, në favor të individeve përfaqësues të shtetit dhe kundër interesave të individeve dhe shoqërisë.

Dhe së fundi tek ne nuk kuptohet, pa lë të synohet, që këto vlera duhen konsideruar si formuese dhe garantuese të solidaritetit kohezionit dhe homogjenitetit të strukturës shoqërore dhe funksionimit të saj në komunitet.

Pra tek ne veprimi në komunitet dhe si komunitet nuk funksionon. E tregon fakti që nuk organizohet asnjë tubim proteste dhe nga askush, për ta detyruar shtetin të plotësojë detyrimet e tij shoqërore. Ose nëse ndodh diçka, si në rastin e minatorëve të kromit, mungon solidariteti dhe përkrahja. Nga ana tjetër te ne çdonjëri është i prirur për të zgjidhur individualisht edhe problemin e dritave, edhe të ujit, edhe të sigurisë, akoma

dhe të drejtësisë. Është një tregues shumë domëthenës i tipit “No koment” fakti që në çdo qytet, shumica e parave të prishura nga çdo qytetar për të siguruar individualisht ujin dhe dritat i kalojnë disa qindra milion dollarë. Mëgjithatë asgjë nuk po zgjidhet, ndërsa me ato para, po të investoheshin së bashku problemet do të kishin hyrë në rrugën e zgjidhjes.

Individi e shikon si të huaj atë që nuk i përket atij personalisht, ose si diçka që duhet shkatëruar si i perket shtetit. Me shtetin ka vendosur vetëm marrëdhënie personale dhe e shikon atë jo si mbrojtës të tij por si kundërshtar, si shfrytëzues dhe armik që i zhvat pa asnjë këmbim vlerat e krijuara prej tij dhe ai duhet të hamerret

Nga ana e vet shteti nga një institucion asnjans dhe i barabartë ndaj të gjithë nënshtetasve të tij, e garantuar kjo barazi me kutin e ligjit, përditë e me shumë po i gjunjëzohet pushtetit politik duke marrë fytyrën konkrete të pushtetarëve dhe të përfaqësuesve të ligjit.

Ky lloj pushteti në përpjekjen e tij për ta përdorur shtetin për favore personale dhe për të konsoliduar përjetësinë e nënshtetit të shtetit, vepron me disa mënyra. Së pari e prish shtetin duke hegjemonizuar kontrollin mbi të gjitha pushtetet. Së dyti, atrofizon dhe nxjerrë jashtë luftimit të gjitha hallkat dhe strukturat e mundshme që do të mund të ushtronin presion dhe kontroll mbi të. Në Shqipëri nuk veprojnë as sindikatat, as shoqatat ambjentaliste, apo të prodhuesve të ndryshëm, as forume të drejtash të njëriut. Ato ose janë formale, ose janë pjesë e ingranazhëve të pushtetit politik, ose kanë si synim kryesor abuzimin me rolin e tyre, ose akoma, synojnë të përdorin këto mjete për t'u bërë pjesë e pushtetit politik ose i sistemit të grabitjes së vlerave shoqërore.

Fakti më domëthenës përbën nulizimi i rolit të rinisë dhe sidomos i asaj studentore. Konfondimi i studimeve me qëllimin në vetvete që është marrja e diplomës me mjete nga më të ndryshme, por që nuk kanë lidhje me studimin dhe dijen, krijon një brez pa kulturë. Tek një brez i tillë nuk mund të kultivohen interesa shoqërore. Një brez i tillë nuk mund të akumulojë e të gjenerojë energji e forca për të bërë sakrificë në emër të një perspektive me të mirë, për të guxuar për ta ndryshuar këtë realitet. Si i tillë po shnderrohet në një minë me sahat me kurdisje të shpejtë kundër së ardhmës dhe shpresës.

Kjo do të thotë se e mira të ne ka pushuar luftën me të keqën. E keqja sundon me forcën e mekanizmave të shtetit.

Në të njëjtin linjë arsyesimi, duhet theksuar, së treti, se shteti, në kuptimin e administruesit të tij, -pushtetit politik, nuk mund të operojë jashtë logjikës së antiligjit. Kështu që kërkon, nxit dhe kultivon përkrahës shkelës të ligjit. Dhe mbi këtë bazë kërkon të garantojë mbajtjen e pushtetit.

Për ta kuptuar këtë argument po u referohemi disa shifrave. Në zgjedhjet e fundit politike dhe lokale moren pjesë pak me shumë ose me pak se një milion e treqind mijë zgjedhës, ose rreth 50 % e votuesve. Po të nisemi nga logjika e analizuar më lartë se individi ka vendosur me shtetin (pushtetin) marrëdhënie interesi personal, kuptohet se shkuan për të votuar ata që kishin interesa të kësaj natyre, ose për të qenë më të saktë ata që u joshën me premtime që në situata normale nuk mund të realizohen. Nën këtë kendveshtrim më të interesuar ishin, psh, ata që iu premtuan legalizimi i ndërtimeve të paligjshëm. Flitet për legalizime objektesh të paligjshëm që në numër i afrojnë të 450 mijë. Nëse këtë numër objektesh e shumëzojmë me të paktën dy votues rezultati është mëse i qartë. Pak me shumë se dy të tretat e votuesve burojnë nga pakti politik i mbrojtjes së shkelësve të ligjit.

Bejmë këtu komentimin se të dy partitë që pretendojnë pushtetin e kishin përfshirë në “programet” e tyre elektorale këtë premtim. Fitoi më shumë vota dhe rrjedhimisht pushtetin, ajo forcë që e ngriti më shumë zerin dhe ishte më bindese. (Ky argument

veshtirë se mund të pranojë komente për faktin se pasi kaluan disa muaj dhe premtimi nuk mbahej, në zgjedhjet lokale balanca e zgjedhësve ndryshoi kahje dhe nxorri fitues kundërshtarin.)

Rrjedhimi logjik i ngritur mbi fakte është se pushtetin në vend e fiton ai që përkrah më shumë shkëlësit e ligjit. (Aq më tepër kur dihet se atyre zgjedhësve që duan respektimin e ligjit kjo politikë nuk ka çfarë të mirë t'u premtojë). Më këtë argument lidhet dhe fakti tjetër që gjithmonë e më shumë në politikë dhe në drejtimin e shtetit tonë hyjnë njëerëz të inkriminuar, ose njëerëz që kanë për suport elementë të kriminalizuar. (Pardje një gazetë botonte lajmin se në telefonat e disa të arëstuarve për krime të rënda ishin numrat e 8 deputeteve. Të mos harrojmë thirrjet e alarmante të Perëndimit, të cilat që para disa vjetësh u binin sirenave të alarmit se krimi i organizuar rrezikon seriozisht të kontrollojë paketën e politikës në Shqipëri.) Kjo po ngrihet në sistem aq sa edhe zgjedhja e presidentit të vendit nuk i shpeton hijës së rëndë të dyshimit se u zgjodh me vota të blera, pra me veprime të inkriminuara.

Në këtë kuptim, serish topi po u mbetet në derë qytetarëve të cilët, në vend që të veprojnë si njësha të shkëputur, në vend që të rrezikojnë jetën dhe të sakrifikojnë çdo gjë për t'u larguar nga "ky vend", duhet te gjejnë njëri tjetrin dhe të pranojë sakrifica kolektive kundër së keqës që po ushqehet nga vet ata. **FUND 15.11.2007** U botua me **17.08.11.2007**

Nga Panajot Barka

## **A kërkon Topi të përfitojë nga prania e përfaqësuesve të minoritetit grek në delegacionin me të cilin ai do të vizitojë Athinën apo këta përfaqësues duan të shfrytëzojnë Topin për kredibilitet në Athinë!?**

22.11.2007

Përbërja e delegacionit shqiptar që do të shoqërojë Presidentin Topi për në vizitën e tij dy ditore në Athinë më 26-27 nëntor, tregon për seriozitetin që kreu i shtetit i ka dhënë kësaj vizite. Të parën vizitë zyrtare të tij në një nivel të tillë dhe në një vend anëtar të Bashkimit Evropian dhe njëkohësisht fqinj. Duket qartë se Presidenti Topi do të synojë të evidentojë me këtë vizitë nivel shumë të mirë marrëdhëniesh midis dy vendeve si realitet dhe si nevojë. Kjo do të thotë se vizita, në pamje të parë, ose në dukje, do të kërkojë gjethe dafine dhe aromë trandafilash, duke u përgatitur njëkohësisht edhe për një plan “B”.

Këtë konkluzion mund ta nxjerrësh fare thjesht po të vesh re qoftë edhe një veçori të delegacionit. Në përbërjen e tij, përveç deputeteve, ministrave dhe përfaqësuesve të tjerë të lartë, përfshihen në mënyrë të diferencuar edhe disa “përfaqësues” të minoritetit etnik grek në Shqipëri dhe autoritetet bashkiake të Gjirokastrës dhe Sarandës.

Në aspektin parimor mesazhi i Presidentit Topi ndaj Athinës është i qartë. Ai kërkon të nënvizojë faktin e rëndësishëm të minoritetit grek në marrëdhëniet midis dy vendeve. Së dyti domosdoshmërinë e ruajtjes së marrëdhënive dhe të bashkëpunimit shumë të mirë të këtij minoriteti me elementin tjetër në jug të vendit, gjë që duhet ta ve re edhe Greqia në politikën e saj ndaj Shqipërisë dhe minoritetit etnik grek këtu.

Mëgjithatë, duke u nisur nga përbërja e përfaqësuesve të minoritetit grek pjesëmarrës në delegacion vëmë re se Presidenti Topi nuk u shkëput nga mentaliteti politik i partisë nga ai vjen. Zgjedhi ata përfaqësues që kanë lidhje të drejtpërdrejt me qeverinë dhe partinë në pushtet. Dulja, Peçi, Bezhani, Çavo. Në këtë delegacion nuk përfshihet deputerti i vetëm minoritar i zgjedhur me votat e minoritetit etnik. (Arsyeja është se i takon partisë në opozitë.) Ashtu si nuk përfshihen figura të tjera politike nga ky minoritet që nuk kanë asnjë lidhje me pushtetin. Pra, kemi të bejmë me një fakt që Athina veshtirë se do ta anashkalojë, dhe pa tjetër që do ta analizojë si argument që Presidenti Topi shkon në Athinë si derivat i Berishës. Dhe jo vetëm përse i përket minoritetit por në përgjithësi si primati i Shqipërisë.

Bën çudi gjithashtu fakti që nuk përfshihet ministri Barka, roli i ministrisë së të cilit është pazgjidhshmerisht i lidhur edhe me emigracionin shqiptar në Greqi. (Përgjigja mund të lidhet me dy arsye. Ose Presidenti Topi ka venë re se Athina zyrtare nuk para e ka qejf ministrin në fjalë. Ose e di që kryeministri Berisha, me propozim të Dulës, ka mendime të tjera për të në rast rikompozimi të kabinetit. Përgjimet dhe arrestimet e ndodhura së fundmi në këtë ministri është një tregues më shumë në favor të kësaj ideje.) Nga ana tjetër, përfshirja në delegacion të disa përfaqësuesve të minoritetit të “integruar” në strukturat qeverisëse dhe shtetërore të Shqipërisë, duket se do të përdoret nga Presidenti Topi si “një kartë e fortë” për të vertetuar “nivele të lartë” të respektimit të të drejtave të minoritetit grek në Shqipëri. (!!!) (Të njëjtën gjë që bën edhe kryeministri në institucionet ndërkombëtare).

Por Presidenti Topi nuk e ka kuptuar se pikërisht këtu do të duhet të kërkojë arsyet e një vizite pa frytet e duhura. Kjo për faktin se argumenti klishe i përdorur kohët e fundit nga Tirana zyrtare, se, për nivelin e lartë të respektimit të të drejtave të minoritetit grek në Shqipëri flet pjesëmarrja e përfaqësuesve nga ky minoritet në qeverisje, ka një

përgjigje domëthenese. Edhe në kohën e diktaturës komuniste, - thotë kjo përgjigje-kishte më shumë se tani përfaqësues nga minoriteti grek në administratën e shtetit. (!!!!)

Ndërkohë, përsa i përket respektimit të të drejtave të minoritetit grek, problemet u shtuan dhe u benë më të mprehta. Atyre, të njohura siç është arsimimi në gjuhën amtare, lëjimi i informimit në gjuhën amtare dhe me mjete të kombit am, regjistrimi i popullsisë etj, tanimë i shtohet edhe problemi që lidhet me nenin 16 të “Konventës Kuadër të KE për mbrojtjen e minoriteteve”. Fjala është për masa dhe veprime të shtetit apo segmenteve të tij që çojnë në ndryshimin e përbërjes së popullsisë në zonat e banuara nga persona që u përkasin minoriteteve. Në të njëjtën kategori përfshihet edhe problemi i rembimit të pronave dhe sipërfaqëve kullësore e livadhore të minoritetit nga gjasëm “ish pronarë” me kombësi shqiptare të kthyer atyre nga struktura të shtetit por me dokumente të falsifikuara.

Heshtja me dashje nga ana e përfaqësuesve të minoritetit grek në lidhje me këto probleme dhe të drejta që i shkelen minoritetit etnik grek, ose heshtja për ta pasur mirë me pushtetin e Tiranës për të përfituar nga ky pushtet për vete, jo vetëm nuk i vjen më në ndihmë politikës së Tiranës, por e ka venë këtë farë udhëheqjeje të minoritetit në distancë të madhe në raport me Athinë zyrtare. Aq me tepër kur vet këta përfaqësues janë kthyer në rrembyes të drejtpërdrejtë dhe për vete të pasurisë së minoritetit. (Një eksponent i tyre në Haskovë të Dropullit të Poshtëm ka arritur të rrembejë 2 000 dynim tokë livadhe, pa patur si trashëgimi as një metër katrore. Familja e tij erdhi një ditë diku nga Permeti dhe vetëm tani vonë u bë me kombësi greke, por roli i tij në OMONIA, PBDNJ dhe mitropolinë e Gjirokastrës ishte i rëndësishëm së dorës së parë.)

Në një optikë të tillë, nuk e teprojmë të themi se, përfaqësuesit nga minoriteti po e shfrytëzojnë vizitën e Topit për t’u pritur nga Athina zyrtare. Eshtë fakt se të paktën këto dy-tri vitet e fundit të gjitha kërkesat e bëra nga Dulja për takime zyrtare në Athinë nuk janë marrë parasysh. Kësaj situatë nuk ke çfarë emri t’i vesh. Këta përfaqësues “të zgjedhur” për të mbrojtur e respektuar të drejtat e minoritetit nga shteti shqiptar, nga njëra anë bashkëpunojnë me shtetin për t’i shitur e për t’i këmbyer këto të drejta dhe interesa të minoritetit për përfitime personale. Nga ana tjetër shkojnë në Athinë me një delegacion zyrtar shqiptar për t’i thenë Athinës se të drejtat e minoritetit respektohen. Ndërkohë që Athina i mban larg.

Kuptohet që në një rast të tillë, prania e përfaqësuesve të udhëheqjes së “lartë” të minoritetit në përberjen e delegacionit të nivelit të lartë, diplomatikisht i heq të drejtën Athinës për t’i kërkuar “hesap” Tiranës për të drejtat e minoritetit. Një qëndrim i tillë do të lë palën shqiptare me gojë të kyçur për problemet që mund të ketë me Athinën. Por mund të ndodhë që Athina të hap gojën për këto të drejta. Ateherë politika e klanit të Dulës çvlerësohet automatikisht në të dy kryeqytetet. Edhe në këtë rast pala shqiptare do të detyrohet të rezervohet për problemet e veta. Pra, sido që të jetë, ky është ngërçi që do ta lë vizitën pa esencë.

Fund 22.11.2007

Nga Panajot Barka

## **Skandali me buxhetin shtetëror për sigurimin e teksteve në gjuhën amtare dhe prapësia e PBDNj-së dhe OMONIA-s në dëm të shkollave publike në MEG**

26.09.2008

Deklarata e deputit nga minoriteti etnik grek me Partinë Socialiste Vangjel Tavo të enjten në parlament se në emer të botimit të teksteve shkollore për arsimin e detyrueshëm në gjuhën amtare të minoritetit grek, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës ka zhdukur 560 milion lekë, duke i lenë për vite me radhë nxënësit e shkollave publike në gjuhën greke pa libra shkollorë të lëndeve në gjuhën amtare, përbën një nga skandalet më të turpshme të kësaj qeverie.

Kjo Ministri harroi detyrimin kushtetues ndaj këtyre nxënësve, harroi se edhe prinderit e tyre paguajnë taksa në këtë shtet, nuk i bënte syri ter se i detyronte këta femijë të mirrinin mësimet në gjuhën amtare me shenime si në shekullin e XIX.

Nuk bëhet fjalë thjesht për korupsion por për shkelje te rendë të të drejtave të njeriut dhe ato etnike të sanksionuara në kushtetutën e vendit dhe ky skandal meriton vemendjen e gjyqit të Hagës.

Preteksti i vetëm ishte se ato kushtojnë shumë shtrenjtë, në një kohë që paratë e akorduara arrijnë për të plotësuar katërfish nëvojat për libra në gjuhën amtare në këto shkolla.

Këmbëngulja e Tiranës se i kushtojnë shumë tekstet e nxënësve minoritarë grekë detyroi Greqinë të marrë përsipër koston financiare dhe botimin e 24 titujve, nga 34 gjithësej. Kjo “arritje” e Ministrisë tonë i ngjante proverbit që thotë :”Mishi të piqet dhe helli të mos digjet”.

Lë të mendojmë për një moment së prapthi. Dmth se jemi në Shqipëri dhe kur në këtë vend arsimit si gjeja më e shtrenjtë e një kombi po masakrohet, rasti i denoncuar nga deputeti Tavo me shifra të mara nga dokumente zyrtare, është, sipas kësaj logjike dicka e rendomtë. Ndokush mund t’i pres edhe ndonjë fletë lavderimi nacionalist ministrisë së Arsimit se ndihmoi në mosarsimimin në gjuhën amtare të “këtyre minoritarëve”. (!!)

Po PBDNj-shi dhe OMONIA në ç’ vrimë do të futen?! Problemi është i rendë dhe përpos të tjerave përbën një krim moral me vlera historike për këtë leadership.

Së pari, ata kurrë nuk e vunë me shpatulla prej muri qeverinë për aktin e saj të paprecedentë brutal të mos sigurimit të teksteve shkollore.

Së dyti janë në qeveri dhe janë njëqind herë më përgjegjës për një veprim të tillë.

Së treti ata janë bashkëpunëtorë të një akti të tillë mesjetar.

Nuk e dimë nëse fituan para dhe sa fituan (mëgjithëse të bën përshtypje se autoritetet e OMONIA-s që mirren me tekstet shkollore në gjuhën amtare na dolën sot me shtëpi botuese dhe me privilegje të admiruara në trajtimin nga shteti.) Për ne pra ka rendësi fakti që ata bashkëpunuan me qeverinë për t’i mbyllur shkollat publike në gjuhën amtare në minoritetin grek. Ky është qendrimi në shkallën ekstreme të politikës së tyre për ta kthyer minoritetin grek dhe interesat e tij në një vrimë të zezë, në një lopë që kanë të drejtë ta mjelin vetëm ata. Ky guxim i tyre ka kapërxyer çdo logjikë normale dhe njëkohësisht përbën një vërtetim se ata dhe për qëllimet e tyre i shiten pjesë-pjesë interesat e minoritetit etnik grek në Shqipëri. Është kjo arsyeja se ata e kanë monokratizuar në duart e një klani të ngushtë PBDNj-në dhe OMONIA-n, kanë asgjesuar aty çdo frymë demokratike dhe nuk i lëshojnë ato karrike duke luftuar me

thonjë e më duart me zjarr edhe me hekur. Është kjo arsyeja se ata janë kthyer në çuna të mirë të çdo qeverie në vend, të majtë apo të djathtë se vetëm kështu minoriteti nuk kërkon të drejta dhe mund të kthehet ai në një magje dhe brum që të vijë sipas interesave të çdo qeverie.

Në këtë kendveshtrim, ndoshta V. Dule e V. Bollano e Co nuk do ta konstatojnë kurrë, por të tjerët, minoritarë e shqiptarë, duhet të bëhen të ndërgjegjeshëm se kostumet e tyre firmato, makinat luksoze, pasuritë e vena vetëm duke ushtruar “politikën e përfaqësimit” të minoritetit etnik grek, tani sjellin mbi vete edhe gjënë më të paimagjinuar. Vulën e vuajtjeve dhe të sakrificave këtyre femijve që me duar që u dridheshin nga të ftohtit në kushtet mizerable të shkollave të tyre, detyroheshin, si në mesjetë, të mirrnin mësimet me shënime. Kanë vulën e vragës së rendë të këtyre femijëve të cilët që në bankat e shkollës krijuan përshtypjen se janë të braktisur nga të gjithë, se nuk ka asnjë vlerë të mësosh gjuhën amtare, të duash atdheun, të duash dijen. Për ne pra ka rendësi fakti që ata bashkëpunuan për t’i mbyllur shkollat publike në gjuhën amtare në minoritetin grek. Dhe jo pa dashje por me ndërgjegje të plotë. Për mese 10 apo 12 vjetesh ata si minj, ndërmoren aksionin për shkërmoqjen e ngadalshëm të shkollave publike në gjuhën amtare në minoritetin etnik grek. Kundërshtuan me forcë bashkimin e disa shkollave me pak nxënës në qendra të zgjeruara shkollore, duke preferuar mbylljen e tyre të natyrshëm. Për vite me radhë u bënë ortakë me neglizhencën e shtetit për mos sigurimin e teksteve shkollore në gjuhën amtare duke i detyruar nxënësit e vegjel të mirrnin mësimet me shënime dhe sipas mundësive përkthyes nga shqipja të mësuesve të tyre. Lanë pa përkrahje dhe me keq akoma, sulmuan dhe denigruan politikisht mësuesit minoritarë grek duke i akuzuar si të shitur dhe të paafte. Morën përsipër përkthimin e atyre teksteve të historisë dhe Gjeografisë së Shqipërisë që tregojnë se kufijtë e saj shtrihen deri në Prevezë dhe Ambraki, me qellimin e mbrashtë, për t’u treguar qarqeve të interesuara greke se shkollat publike nuk i shërbëjnë edukimit patriotik grek të nxënësve minoritarë. Penguan çdo përpjekje dhe inisiativë për hartimin e programeve mësimore në përshtatje të reformës në arsimin e detyrueshëm nga tetë në nentëvjeçar. Lanë në kushte mjerane shkollat publike egzistuese në minoritetin etnik grek, lanë të shkatërrohet e vetmja shkollë e mesme në gjuhën greke, sulmuan madje edhe Departamentin e Gjuhës, Letërsisë e Qytetërimit Grek në Universitetin “E.Çabej “ në Gjirokastrë.

Në ditën e parë të hapjes së shkollave sivjet, asnjë nga liderat e PBDNJ-së dhe OMONIAS nuk asistuan në shkollat publike në gjuhën amtare. Përkundrazi u bënë karshillek atyre duke asistuar në shkollat private të hapura nga ata vet. Më e rendë situata në Gjirokastrë ku këta asistuan në hapjen e një shkolle të re të palicensuar nga shteti pranë Mitropolisë së Shenjtë të Kishës Autoqefale Shqiptare në këtë qytet. Hapja e saj çoi në mbylljen e shkollave publike në gjuhën amtare në zonë e Dropullit. Ditët që pasuan u shoqëruan me sulmin e Drejtorisë Arsimore mbi shkollën publike në gjuhën greke në qytetin e Gjirokastrës. Në bazë të një rregulli të dalë në vitet 1993-95, periudhë e “luftës së ftohtë” në marrëdhëniet Shqipëri –Greqi dhe që zbatohet sipas orekseve apo kur shikohet se duhet frenuar kjo shkollë, u hoqen nga bangat e saj të gjithë ata nxënës që nuk janë 100% minoritarë grek. (!!)

Ndërsa të tjerë nxënës edhe pse 100 % grek nuk u lëjuan të regjistrohen atje (Me këtë frymë instrumentat qeveritare do të çojnë Shqipërinë në Evropë). Qëllimi u diktua shpejt. Këta femijë të hequr, sidomos nga klasa e parë, të regjistroheshin në shkollën private të sapo hapur, të cilën shteti duhet ta mbyllë.

Të gjitha këto pra me qellimin e mprashtë të zëvendësimit të këtyre shkollave publike me shkolla private. Interesi i tyre i vetëm përfitimi ekonomik dhe krijimin e shtresës elektorale mbeshtetëse të tyre në minoritet. Në këtë qellim të mbrashtë bën



aleate kishën Ortodokse Autoqefale Shqiptare, e cila, për shkak të ndjeshmerive të njohura, u krijon atyre një mbeshtetje në Greqi.

Ata harrojnë se me këto veprime, për të cilat nuk ka asnjë vendim politik kolegjal, përkundrazi, harrojnë, pra se po i japin një goditje të rëndë të arsimit në gjuhën amtare dhe të integritetit si njesi etnike të minoritetit grek në Shqipëri ndaj të cilit ka detyrime kushtetuese shteti shqiptar dhe nëpërmjet kësaj hallke, shkollës publike, ky minoritet krijon më shumë mundësi integrimi me shtetin dhe shoqërinë shqiptare.

Gjthashtu, kujtuan se përfaqësimi i minoritetit grek me mënyra teokratike me metoda që të kujtojnë intrigat bizantine, do të mund të fshihnin prapësitë e tyre kundër interesave themelore të egzistencës së njësi etnike të këtij minoriteti.

Skandale të tjera pritet t'u shpërthejnë në të ardhmën afërt. Fjala është për trojet dhe pasuritë në Himarë, për kullotat dhe livadhet në pjesët e tjera të minoritetit, për lëjimin antikushtetues të prishjes së ekulibrave demokrafikë në zonat me popullsi kompakte minoritare.

26.09.2008